

FIRMOSEN MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT ME 23 ORGANIZATA FITUESE TË THIRRJES SË TRETË PËR PROJEKT-PROPOZIME NGA AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, **u nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me 23 organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, projektet e të cilave janë shpallur fituese nga Thirrja e tretë për projekt-propozime rinore**, që po financohet me mbështetjen e qeverisë nëpërmjet AKR-së. Të pranishme në event ishin edhe znj. Elida Nuri nga UNFPA dhe znj. Edina Kozma nga UNICEF, organizata të cilat do të mbështesin financiarisht 3 nga projektet fituese. Organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, përgjatë 12 muajve të ardhshëm do të implementojnë projektet, në kuadër të të cilëve do të zhvillojnë aktivitete në përputhje me tre qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetjen e aktivizmit shoqëror dhe qytetar të tyre, nxitjen e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës dhe mbështetjen e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.



RINCAMP 2023 MBLEDH SË BASHKU 100 TË RINJ NGA E GJITHË SHQIPËRIA

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë dhe UNICEF Albania e World Vision Albania, partnerë dhe mbështetës në përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, nga data 31 gusht deri më 3 shtator organizuan "RinCamp 2023" në Dhërmi, qëllimi i të cilit është të ndihmojë të rinjtë të zgjerojnë horizontet e tyre, të zhvillojnë aftësi të reja, si dhe të socializohen me njëri-tjetrin. Në "RinCamp 2023" morën pjesë **100 të rinj nga qytete të ndryshme të Shqipërisë**, të cilët përgjatë kampit u njohën me këndvështrimet dhe përvojat e 26 panelistëve rreth **tranzicionit në tregun e punës – risitë dhe ndryshimet e tregut në vitet e fundit; digjitalizimit të vendit të punës dhe arsimit; kërkimit shkencor mbi politikat rinore; strukturat vendore rinore; zhvillimin e aftësive të leadershipit dhe aftësive ndërpersonale; si dhe aftësive të buta**. Në përfundim të kampit, të rinjtë sugjeruan programe e nisma që mund të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë së jetesës tek të rinjtë, në përputhje me tre qëllimet politike të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për fuqizimin e të rinjve.



531 TË RINJ FILLUAN PRAKTIKËN 3 MUJORE PËRGJATË MUAJIT SHTATOR

Në kuadër të Thirrjes së VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, më datë **1 shtator 531 të rinj filluan praktikat 3 mujore në institucionet pritëse**, ku ata do të asistohen gjatë procesit të zbatimit të njohurive teorike dhe përvetësimit të atyre praktike. Institucioni i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është gjithashtu i përfshirë në Thirrjen e VIII të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, prej të cilit, pas përfundimit të procesit të vlerësimit të aplikantëve, dy prej tyre iu bashkuan institucionit të MSHRF. Ndër të tjera, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti Eslin dhe Lejdin, për t'u uruar një fillim të mbarë praktike pranë Ekipit të Rinisë, ku do të jenë jo vetëm një vlerë e shtuar ekipit, por edhe do të zhvillohen profesionalisht.



PËRFAQËSIMI I SHQIPËRISË NË HACKATHON-IN EU CODEWEEK NË BRUKSEL

Nga data 8 deri më 10 shtator u zhvillua Hackathon-i CodeWeek Albania në kuadër të javës së teknologjisë së Bashkimit Evropian, ku Shqipëria u përzgjodh për herë të parë nga EU CodeWeek si një ndër 6 shtetet fituese për të zhvilluar një hackathon me të tilla përmasa me mbështetjen e Komisionit Evropian. **Gjatë tre ditëve maratonë të Hackathon-it CodeWeek Albania morën pjesë 50 të rinj të moshës 15-19 vjeç**, nga e gjithë Shqipëria dhe u përballën me njëri-tjetrin për të gjetur zgjidhje inovatore teknologjike për sfidat aktuale të vendit në fushën e arsimit, transportit, turizmit, mbrojtjes dhe ruajtjes së ambientit, monitorimin e ajrit, ujit dhe zjarreve. Tre grupet fituese, "Unyo", "Journey Buddy" dhe "Navigate Tirana" do të përfaqësojnë Shqipërinë në Hackathon-in që do të mbahet në Bruksel në muajin tetor. CodeWeek Albania vjen për herë të parë si partneritet i EU CodeWeek me Albanian ICT Academy, Agjencinë Kombëtare të Rinisë, Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe STEM.

ZHVILLOHET PANAIRI PËR TË RINJTË NË QARKUN E SARANDËS.

Më datë 22 shtator, në kuadër të qëllimit të dytë të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës, **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizoi Panairin për të Rinjtë, për arsim, edukim dhe punësim në qytetin e Sarandës me qëllim informimin e të rinjve në këto drejtime dhe për të lehtësuar kalimin e tyre nga shkolla në tregun e punës.** 25 institucione, biznese e organizata, njohën të rinjtë me mundësitë që ata ofrojnë për edukim, arsim dhe punësim në qytetin e Sarandës, por jo vetëm, në përputhje me qëllimet dhe profesionet e të rinjve, por edhe me kërkesat e tregut të punës.




MBYLLEN APLIKIMET PËR ANËTARË PËR KËSHILLIN KOMBËTAR RINOR, VIJON PROCESI I VOTIMEVE PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti më 25 shtator 15 nga 42 aplikantët e thirrjes për anëtarë të Këshillit Kombëtar Rinor, **i cili funksionon si një organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për rininë, duke sugjeruar dhe ofruar një panoramë më të gjerë rreth politikave rinore dhe nevojave të të rinjve anë e mbanë vendit.** Thirrja për aplikimet për anëtarë të Këshillit Kombëtar Rinor u hap përgjatë muajit korrik dhe u mbyll më 8 shtator. Komisioni i certifikimit përfundoi procedurat për vlerësimin e dokumentacionit të secilit prej aplikantëve, dhe për aplikantët e përzgjedhur nga komisioni më datë 27 shtator filloi procesi i votimit nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë për të zgjedhur përfaqësuesit e zërit të të rinjve pranë nivelit qendror të politikëbërjes për dy vitet e ardhshme.



FILLIMI I VITIT TË RI SHKOLLOR

Më 11 shtator, në ditën e parë të shkollës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ndryshe nga çdo fillim viti shkollor, vizitoi shkollën jopublike TES për t'u uruar suksese fëmijëve por edhe për të ftuar shkollën të bëhet pjesë e Programit të Kodimit në Shkolla, i cili së shpejti do të ofrohet edhe për shkollat jopublike, duke filluar me klasën e parë. **Programi i Kodimit në Shkolla filloi zbatimin në 100 shkolla në të gjithë vendin, dhe së shpejti do të shtrihet edhe në 216 shkolla të tjera.** Falë mbështetjes së Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim të gjitha shkollat jopublike që dëshirojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre të mësimdhënies teknologjike dhe dëshirojnë të bëhen pjesë e Programit të Kodimit në Shkolla, do t'u ofrohet qasja në platformën CodeMonkey, kurrikula mësimore për lëndën e kodimit si dhe trajnimi i mësuesve në përputhje me të gjitha komponentët e programit, në mënyrë që ecuria të jetë e njëjtë me atë të shkollave publike.



EDUKIMI I TË RINJVE PËR MIRËMBAJTJEN E LUMIT "VJOSA" TË SHPALLUR PARK KOMBËTAR

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pastrimit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët vizitoi lumin "Vjosa", të shpallur tashmë Park Kombëtar nga qeveria, me qëllim promovimin e mbrojtjes së lumit tek të rinjtë e qytetit të Përmetit dhe zonave për rreth, mirëmbajtjen e ambientit të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës. Ndër të tjera, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Kryetaren e Bashkisë znj. Alma Hoxha biseduan me **përfaqësuesit e Këshillit Vendor dhe të rinjtë e zonës, rreth çështjeve që i shqetësojnë dhe rritjes së përfshirjes së tyre në jetën sociale,**



në kuadër të së cilës Bashkia Përmet po ndërton një qendër rinore, ku të rinjtë do të kenë akses për të shpenzuar kohë cilësore së bashku e mbi të gjitha për të pasuruar dijet e tyre me anë të bibliotekës që do të ngrihet brenda qendrës rinore.

STUDIMI SHKENCOR "ZËRAT E TË RINJVE: BARAZIA GJINORE DHE KOHEZIONI SOCIAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR" I REALIZUAR NË KUADËR TË PROJEKTIT "TË RINJTË PËR GJITHËPËRFSHIRJE, BARAZI DHE BESIM"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar për kërkimin shkencor "Zërat e të rinjve: Barazia gjinore dhe kohezioni social në Ballkanin Perëndimor", realizuar nga një grup të rinjsh në kuadër të projektit "Të rinjtë për gjithëpërfshirje, barazi dhe besim" i zbatuar nga organizata UN Women Albania, për të evidentuar shqetësimet e të rinjve, si dhe për të pritur sugjerime dhe propozime nga vetë të rinjtë për t'i zgjidhur çështjet që i shqetësojnë. Sipas rezultateve të studimit, **të rinjtë e rajonit janë pro barazisë gjinore dhe kohezionit social, të ndërthurura këto me një sërë elementësh të tjera si, edukimi cilësor për barazin gjinore në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, inkurajimi për qytetarë aktivë, për të krijuar hapësira diskutimi rreth çështjeve me të cilat të rinjtë përballen në përditshmërinë e tyre.**



TRAJNIMI I MËSUESVE PËR KURSIN E VETËMBROJTJES NË KUADËR TË PROGRAMIT JASHTË ORARIT MËSIMOR

Në kuadër të programit Jashtë Orarit Mësimor, i cili zbatohet në 200 shkolla në të gjithë vendin dhe janë të angazhuar rreth 10000 fëmijë, për të dytin vit radhazi, mentorët e ESD me mbështetjen e UN Women, zhvilluan trajnime për mësuesit të cilët japin kursin e vetëmbrojtjes, **me qëllim ofrimin e sigurisë personale për fëmijët dhe të rinjtë**, që të fitojnë aftësi vetëmbrojtjeje, të luftojnë bullizmin, të fitojnë vetëbesim dhe të adresojnë rastet e dhunës në ambientet e shkollave dhe jashtë saj tek autoritetet përkatëse. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë gjatë trajnimit për të siguruar vijueshmërinë e tij në përputhje me standardet që ofron programi Jashtë Orarit Mësimor, por edhe për të diskutuar me 27 mësuesit e pranishëm rreth çështjeve të ndryshme që hasin gjatë punës së përditshme, duke u fokusuar në zgjidhje efektive dhe afatgjata.

